VENDIM
Nr. 117/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 11/2021 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI (ISKK)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", të ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 11/2021 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", të ndryshuar, ndryshon sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.11.2023.

Lidhja 2. ORGANIKA E INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

	Funksioni	Klasa e pagës	Nr. i punonjësve
I	**DREJTORI EKZEKUTIV**	*I-2*	***1***
II	**DREJTORIA E ARKIVIT DHE BIBLIOTEKËS**		**5**
	Zv.drejtor ekzekutiv dhe drejtor i arkivit	I-4	**1**
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	IV-1	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	IV-1	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	IV-1	1
	Specialist biblioteke (katalogim, inventarizim i fondit të Bibliotekës etj.)	IV-1	1
III	**DREJTORIA E STUDIMEVE**		***10***
	Drejtor drejtorie	II-1	**1**
	Sektori i Kërkimit Shkencor		***5***
	Përgjegjës sektori – studiues	III-1	**1**
	Specialist studiues	IV-1	1

	Specialist studiues	IV-1	1
	Specialist studiues	IV-1	1
	Specialist i botimeve dhe redaktor letrar	IV-1	1
	Sektori i Edukimit dhe Informimit Publik		***4***
	Përgjegjës sektori – studiues	III-1	**1**
	Specialist i projekteve audiovizuale	IV-1	1
	Specialist i marrëdhënieve me publikun	IV-1	1
	Specialist – koordinator i edukimit	IV-1	1
	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**6**
	Drejtor drejtorie	II-1	**1**
	Specialist i financës dhe buxhetit	IV-1	1
	Specialist i burimeve njerëzore dhe sekretari/protokoll	IV-1	1
	Specialist jurist dhe i shërbimeve me gjyqësorin	IV-1	1
	Specialist IT (database ISKK/Arkivi elektronik)	IV-1	1
IV	Shofer	Kl. IV	1
	PUNONJËS GJITHSEJ		**22**